



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

Njoftim për pozicion vakant

Në kuadër të Projektit fitues REEHUB (Regional Energy Efficiency Hub), pjese e Programit INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, financuar nga Bashkimi Evropian, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si Lead Partner ne projektin fitues REEHUB, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës si në vijim:

I. Menaxher Projekti në kuadër të Projektit fitues REEHUB pjesë e Programit të financuar nga BE, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, në Tiranë.

Detyrat e Menaxherit të Projektit

Aktiviteti i Menaxhimit dhe Monitorimit do të kryhet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke synuar të kontrollojë dhe menaxhojë zhvillimin e projektit në të gjitha fazat e tij. Në këtë kuadër roli i Menaxherit të Projektit është shumë i rëndësishëm në koordinimin dhe menaxhimin e punëve ndërmjet partnerëve përgjatë gjithë fazave të implementimit të projektit. Për të përmbushur objektivat e caktuara Menaxheri i projektit duhet të kryejë detyrat si më poshtë:

- Të njihet me projektin dhe WP për të cilat është përgjegjës;
- Të hartojë një plan pune për realizimin e objektivave të WP
- Të përcaktojë politikën, procedurat dhe dokumentacionin për planifikimin, zhvillimin, menaxhimin, ekzekutimin dhe kontrollimin e aktiviteteve të projektit.
- Të koordinojë Komitetin e Menaxhimit të Projektit, i cili do të monitorojë progresin e projektit në termat financiar dhe kohorë;
- Të monitorojë performancën dhe progresin e projektit kundrejt planit kohor dhe financiar;
- Të bëjë propozime për të amenduar plane nëse ndodhin të papritura gjatë projektit;
- Të koordinojë komunikimin midis partnerit drejtues dhe partnerëve të projektit, përgjatë zhvillimit të aktiviteteve;
- Të mbajë komunikimin me partnerët me qëllim shpërndarjen e informacionit dhe vendosjen e takimeve midis partnerëve.
- Të dorëzojë raportet financiare dhe progres raportet tek zyra e Programit;

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Diplomë universitare dhe pasuniversitare mundësisht në një nga vëndet e BE-së (minimumi 5 vjet studime në disiplinën e Inxhinierisë së Ndërtimit, Arkitekturës dhe Inxhinierisë Elektrike, master ose PhD në lidhje me Projektimet e Qëndrueshme dhe Efiçencën e Energjisë);

- Të paktën 3 vjet eksperiencë profesionale në 5 vitet e fundit, në fushën e shkrimit, menaxhimit, koordinimit dhe raportimit të projekteve të financuara nga BE ose donatorë të tjerë;
- Të ketë aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese për të punuar në një projekt me shumë partnerë ndërkombëtarë dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis palëve;
- Të ketë eksperiencë në projekte që kanë të bëjnë me Projektimet e Qëndrueshme dhe Efiçencën e Energjisë;
- Rrjedhshmëri në gjuhën e shkruar dhe të folur italiane dhe angleze;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike (Excel, Word processing, përgatitja e prezantimeve);

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin *European* ;
- Fotokopje të diplomave universitare, master, PhD;
- Fotokopje të Diplomave/Certifikatave që provojnë njohuritë e gjuhës angleze (nëse diploma universitare është marrë në një program studimi në gjuhën angleze ose italiane, nuk është e nevojshme dëshmia e gjuhës);
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit deri më datë **25/06/2019**, ora 10.00, në adresën si në vijim: *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rr. Abdi Toptani, Nr.1, 1001, Tiranë, Shqipëri*, me subjekt:

Aplikim për pozicionin Menaxher Projekti , Projekti REEHUB, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi

II. Kordinatori Projekti në kuadër të Projektit fitues REEHUB pjesë e Programit të financuar nga BE, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, në Tiranë.

Detyrat e Kordinatorit të Projektit

Kordinatori i projektit do të kontrollojë ecurinë e projektit duke monitoruar dhe vlerësuar rezultatet si edhe duke koordinuar partnerët përgjatë gjithë fazave të implementimit të projektit. Për të përmbushur objektivat e caktuara Kordinatori i projektit duhet të kryejë detyrat si më poshtë:

- Të njihet me projektin dhe WP për të cilat është përgjegjës;
- Të hartojë një plan pune për realizimin e objektivave të WP
- Të jetë përgjegjës për ndërgjegjësimin publik.
- Të mbajë komunikimin me kordinatorët e tjerë të partnerëve.
- Të koordinojë komunikimin midis partnerit drejtues dhe partnerëve të projektit, përgjatë zhvillimit të aktiviteteve;
- Të mbajë komunikimin me partnerët me qëllim shpërndarjen e informacionit dhe vendosjen e takimeve midis partnerëve.
- Të hartojë në bashkëpunim me partnerët progres raportet;

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Diplomë universitare
- Të ketë aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese për të punuar në një projekt me shumë partnerë ndërkombëtarë dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis palëve;
- Rrjedhshmëri në gjuhën e shkruar dhe të folur në një nga gjuhët e BE;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike (Excel, Word processing, përgatitja e prezantimeve);

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin *European* ;
- Fotokopje të diplomave universitare,
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit deri më datë **25/06/2019**, ora 10.00, në adresën si në vijim: *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rr. Abdi Toptani, Nr.1, 1001, Tiranë, Shqipëri*, me subjekt:

Aplikim për pozicionin Kordinatori Projekti Projekti , Projekti REEHUB, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi

III. Ekspert financiar në kuadër të Projektit fitues REEHUB pjesë e Programit të financuar nga BE, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, në Tiranë.

Detyrat e ekspertit financiar të projektit

Eksperti financiar do të kontrollojë, monitorojë ecurinë e shpenzimeve sipas zërave në projekt, duke bërë vlerësimet e tyre sipas periudhave të raportimit. Për të përmbushur objektivat e caktuara eksperti financiar duhet të kryejë detyrat si më poshtë:

- Të njihet me projektin dhe WP për të cilat është përgjegjës MIE;
- Të hartojë një plan pune për realizimin e objektivave të WP
- Të jetë përgjegjës për ndryshimet në zërat e buxhetit.
- Të mbajë komunikimin me zyren e financave të ministrisë.
- Të përgatis time sheet për personelin e ministrisë.
- Të mbajë faturat e shpenzimeve sipas zërave në projekt.

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Diplomë universitare në shkencat ekonomike
- Përvojë pune në profesion të paktën 2 vjet
- Të ketë aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese për të punuar në një projekt me shumë partnerë ndërkombëtarë dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis palëve;
- Rrjedhshmëri në gjuhën e shkruar dhe të folur në një gjuhë të BE;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike (Excel, Word);

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin *European* ;
- Fotokopje të diplomave universitare,
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit deri më datë **25/06/2019**, ora 10.00, në adresën si në vijim: *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rr. Abdi Toptani, Nr.1, 1001, Tiranë, Shqipëri*, me subjekt:

Aplikim për pozicionin Ekspert financiar, Projektit REEHUB, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi

IV. Ekspert ligjor në kuadër të Projektit fitues REEHUB pjesë e Programit të financuar nga BE, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi, në Tiranë.

Detyrat e ekspertit ligjor të projektit

Eksperti ligjor do të kontrollojë, monitorojë ecurinë e periudhave të raportimit. Për të përmbushur objektivat e caktuara eksperti ligjor duhet të kryejë detyrat si më poshtë:

- Të njihet me projektin dhe WP për të cilat është përgjegjës MIE;
- Të hartojë një plan pune për realizimin e objektivave të WP
- Të jetë përgjegjës për hartimin e termave të referencës për paketat e prokurimeve sipas zërave në projekt.
- Të mbajë komunikimin me menaxherin e projektit dhe personelit të ministrisë përgjegjës për ecurinë e projektit.
- Të hartojë në bashkëpunim me partnerët progres raportet;

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Diplomë universitare në shkencat juridike
- Përvojë pune në profesion të paktën 2 vjet
- Të ketë aftësi shumë të mira koordinuese, organizative dhe komunikuese për të punuar në një projekt me shumë partnerë ndërkombëtarë dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis palëve;
- Rrjedhshmëri në gjuhën e shkruar dhe të folur në një gjuhë të BE;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike (Excel,Word);

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin *European* ;
- Fotokopje të diplomave universitare,
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit deri më datë **25/06/2019**, ora 10.00, në adresën si në vijim: *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rr. Abdi Toptani, Nr.1, 1001, Tiranë, Shqipëri*, me subjekt:

Aplikim për pozicionin Ekspert ligjor, Projekti , Projekti REEHUB, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi